



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

ANALIZË VJETORE MBI PUNËN E PROKURISË SË APELIT TIRANË PËR VITIN 2019

Përbajtja

Hyrje

1. Zbatimi i Rezolutës nr.2, datë 20.6.2019, i KRSH-së “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2018”
2. Zbatimi i rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019, miratuar me vendimin nr.296, datë 10.5.2019, të KM
3. Zbatimi i udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm
4. Të dhëna statistikore për veprimtarinë e institucionit
5. Informacion për zbatimin e ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”
6. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Përfundime

Hyrje

Të nderuar kolegë,

Analiza vjetore e institucionit të Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2019, pasqyron në mënyrë të përbledhur treguesit e punës tonë, nën dritën e ndryshimeve thelbësore, që kanë shoqëruar sistemin e drejtësisë në vend. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe paketa ligjore, për reformimin e sistemit të drejtësisë kanë në fokusin e tyre, angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve dhe aktorëve në vend, por mbi të gjitha angazhimin e drejtëpërdrejtë të trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Arritjet dhe problematikat e konstatuara përgjatë vitit 2019, janë në të njëjtën kohë edhe sfidat me të cilat jemi përballur. Gjatë vitit që kemi lënë pas, trupa e prokurorëve ka treguar përkushtim profesional dhe eficencë të plotë në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për nga numri dhe rëndësia e çështjeve që trajtojmë, ne mbetemi një hallkë e rëndësishme, pasi shqyrtojmë numrin më të madh të çështjeve në shkallë vendi, që gjykohen në shkallë të dytë.

E gjithë veprimitaria e institucionit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, në vitin 2019 ka reflektuar qasjen e re, që parashevligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Nisur nga ky këndvështrim, organizimi dhe funksionimi i brendshëm i Prokurorisë është mbështetur në pavarësinë e punës së prokurorëve.

Në vijim, në funksion të organizimit dhe ndarjes së punës, nga ana ime si drejtues, janë marrë masat e duhura, që shpërndarja e ngarkesës të bëhet në funksion të përfaqësimit dinjitoz në gjyq. Kështu, për masat e sigurimit është përdorur sistemi i prokurorëve të gatshëm, me grafik mujor, duke respektuar sistemin e radhës sipas grafikut. Kjo mënyrë organizimi ka rezultuar efikase, pasi në të gjitha masat e sigurimit jemi përfaqësuar në

orën dhe datën e caktuar për gjykim dhe, nuk ka as edhe një rast, që çështja të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së prokurorit. Për çështjet e themelit nga ana ime është treguar kujdes, që trajtimi e ndarja e çështjeve, ndërmjet prokurorëve të jetë e barabartë, jo vetëm duke u nisur nga numri, por edhe nga shkalla e rezikshmërisë dhe e rëndësisë së çështjes, numrit të pandehurve, ndarje në mënyrë të barabartë të çështjeve, që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve dhe ankimeve të bëra nga të pandehurit. Tash, nga Gjykata e Apelit është një praktikë e konsoliduar, që çështjet e themelit na vihen në dispozicion për t'u studiuar, të paktën 1 muaj para fillimit të gjykimit. Ky fakt, na ka mundësuar, që prokurorët të kenë kohën e mjaftueshme për t'i studiuar e, për rrjedhojë, për t'u përfaqësuar në gjykim në mënyrë dinjitoze.

Në funksion të përbushjes së detyrave dhe veprimtarisë së punës së prokurorëve, ka asistuar administrata, e cila ka krijuar infrastrukturën e nevojshme teknike, brenda kompetencave dhe detyrimeve ligjore të secilit punonjës.

Me qëllim që puna jonë të jetë e pasqyruar, transparente dhe e kontrollueshme në çdo kohë, sërisht vazhdojmë praktikën e paraqitjes në gjykatë të konkluzioneve tona me shkrim.

Në mbështetje të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në përbushje të detyrimeve ligjore si drejtues, kam miratuar udhëzimin nr.1, datë 24.1.2019 “Për organizimin dhe marrjen e masave për mirëfunksionimin e punës në Prokurorinë e Apelit Tiranë”.

Ky udhëzim është nxjerrë me qëllim kontrollin e ligjshmërisë dhe mundësishët unifikimin e qëndrimit të prokurorëve para Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët duhet të paraqesin konkluzionet me shkrim tek drejtuesi i Prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve punë, përpara fillimit të seancët gjyqësore për rastet e qëndrimit ndryshe nga prokurori i shkallës së parë.

Ky parashikim është edhe për masat e sigurimit, ku prokurorët duhet të paraqesin konkluzionet me shkrim tek drejtuesi i Prokurorisë brenda 1 (një) ditë pune, përpara fillimit të seancës gjyqësore.

Në bazë të të dhënave të administruara, ky udhëzim është zbatuar përgjithësisht në mënyrë korrekte nga stafi i prokurorëve dhe, në shumë raste, drejtuesi i prokurorisë është shprehur me udhëzim të posaçëm, me mendim ndryshe për zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Po kështu, për çdo çështje masë sigurimi, themeli etj, mbahet në arshivë një minidosje, e cila përmban aktet kryesore të çështjes së gjykuar.

Në lidhje me sektorin e financës për vitin 2019, është punuar për uljen në maksimum të shpenzimeve buxhetore, pa cenuar përbushjen e nevojave të domosdoshme. Sektori i financës ka përbushur veprimtarinë e tij, duke zbatuar me korrekësi legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin e kontrollin finansiar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

E fundit, por jo nga rëndësia, ka qenë kujdesi që është treguar në vazhdimësi nga ana ime si drejtues, i ushtrimit të funksioneve të secilit prokuror brenda kodit të etikës. Është pjesë e suksesit të punës, jo vetëm paraqitja në seancë gjyqëore në datën, orën e caktuar, por edhe mënyra e komunikimit me trupin gjykues e palët në proces, paraqitja e jashtme dinjitoze, respektimi i disiplinës në punë, për të cilat gjej rastin të falënderoj të gjithë kolegët.

Gjatë këtij raporti do të përqendrohemë në disa dukuri dhe aspekte ligjore të punës, të evidentuara gjatë vitit 2019.

Më lejoni, të paraqes një përbledhje të veprimtarisë së institucionit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, si më poshtë vijon:

1. Zbatimi i Rezolutës nr.2, datë 20.6.2019, i KRSH-së “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2018”

Në përbushje të angazhimeve, që Kuvendi i RSH-së ka përcaktuar për vitin 2019, në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2019”, për sa i përket forcimit të luftës kundër korruptionit dhe krimit të organizuar, zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatusse brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, si dhe monitorimit e respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, institucioni i Prokurorisë së Apelit, brenda fushës së veprimtarisë që mbulon, ka ndërmarrë një sërë hapash konkretë në funksion të realizimit të këtyre detyrimeve që burojnë nga kjo rezolutë. Më konkretisht:

- i) forcimit të luftës kundër korruptionit dhe krimit të organizuar :
- ii) zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatusse brenda dhe jashtë vendit :
- iii) bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës :
- iv) monitorimit e respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale,

institucioni ynë do të vazhdojë përpjekjet për përbushjen e detyrimeve të kësaj rezolute dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin penal në fuqi.

2. Zbatimi i rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019, miratuar me vendimin nr.296, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave

Në zbatim të rekomandimeve prioritare të miratuara nga Këshilli i Ministrave, më lejoni të parashtroj si më poshtë vijon:

- i) në luftën kundër korruptionit, qëndrimi i prokurorëve të Apelit ka qenë serioz në mbrojtjen e akuzave që lidhen me veprat penale në fushën e korruptionit dhe caktimin e masave relativisht të larta të dënimit, me qëllim parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të kësaj dukurie;
- ii) për forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, jemi përpjekur të zbatojmë korrekt në praktikë detyrimet që parashev ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, në rastet kur kemi të bëjmë me të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë në vepra penale, në funksion të garantimit të një drejtësie miqësore për të miturit.

3. Zbatimi i udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm

Për sa i përket zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, jemi përpjekur t'i zbatojmë ato në mënyrë të harmonizuar e në përputhje me atë çka parashikon legjislacioni penal në fuqi.

4. Të dhëna statistikore për veprimtarinë e institucionit

Për sa i përket përbushjes së funksionit themelor të institucionit të Prokurorisë, atë të zbatimit të Kushtetutës dhe legjislacionit penal në praktikë, kemi synuar zbatimin e këtij legjilsacioni me objektivitet. Kemi mbështetur në masë apelet e Prokurorëve të Shkallës së Parë, pasi kanë qenë apele, që kanë qëndruar dhe me shkaqe ligjore.

Analiza konkrete dhe e qartë e treguesve të punës për vitin 2019, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga veprimtaria e përditshme, gjykojmë se i shërben nxjerrjes më mirë në pah të rezultateve të punës sonë. Kështu, në Prokurorinë Apelit Tiranë, gjatë vitit 2019, është

përballuar një volum pune i madh për çështje themeli e masa sigurimi, edhe pse në një numër të reduktuar prokurorësh.

Prokuroria e Apelit Tiranë, ka përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, **1089 çështje penale në themel, me 1273 të pandehur**. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me **vitin 2018**, ku janë gjykuar **2155 çështje penale në themel, me 2520 të pandehur**, numri i çështjeve ka një zbritje prej **1066** çështje .

Për sa i përket masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit, janë gjykuar **996 masa sigurimi personal**. Krahasuar me **vitin 2018**, ku janë gjykuar **958 masa sigurimi personal, ka një rritje të masave të gjykuara**.

Prokurorët i kanë kushtuar kujdes të veçantë studimit të çështjeve të themelit, për t'u përfaqësuar me cilësi në gjyq. Lidhur me çështjet e themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar, mbi **apelin e prokurorit 303 çështje ose 27,8%** dhe, mbi **ankimin e të pandehurve 786 çështje ose 72.2% të rasteve**. Ndërsa, për sa i përket **masave të sigurimit në 996 raste, 145 raste** kanë ardhur në Prokurorinë e Apelit, **mbi bazën e apelit të Prokurorit ose 14,5 %**.

Rëndësi të veçantë në punën e prokurorëve ka patur studimi i apeleve të prokurorëve. Kështu, **303 çështje** janë mbi apelin e prokurorit. Nga këto, nga prokurorët e apelit, nuk janë mbështetur **125 apele ose 41,2%**. Nga këto, në 9 raste të ardhura mbi apelin e prokurorit është kërkuar pushimi i çështjes për shkak të ligjit mbi amnistinë.

Prokurorët kanë përkrahur apelet në shumicën e rasteve. Për çështje themeli Gjykata e Apelit Tiranë, **nga 178 apele të përkrahura nga prokurori, ka pranuar apelet e prokurorit në 25 raste ose rrëth 14%**. Kjo përqindje, krahasuar me përqindjen e pranimit të apeleve në vitin 2018 (20, 4 %), është pak më e ulët.

Në 814 raste, nga prokurorët e apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit **në 616 raste ose 75.9%**. Nga **192 çështje** të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi kërkuesat e prokurorëve për lënie në fuqi dhe

pranim apeli, janë pranuar konkluzionet e prokurorëve për 25 çështje ose e shprehur në përqindje **24.1%**. Vërehet, se ka një rënie, krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019 janë pushuar çështjet në 47 raste. Kjo për shkak të ligjit për amnistinë ose për mungesë të objektit të shqyrtimit në Apel.

Sipas rretheve, apelet janë të shpërndara si më poshtë vijon:

- Tirana ka 247 apele, janë përkrahur nga prokurori 137 apele dhe është hequr dorë ose mospranuar apeli në 110 raste, ndërsa gjykata ka pranuar apele 17.
- Kruja ka 9 apele, është hequr dorë nga apelet ose mospranuar apeli në 3 raste, janë përkrahur 6 apele nga prokurori, Gjykata e Apelit ka pranuar 2 apele.
- Kurbini ka 26 apele, është hequr dorë ose mospranuar apeli në 6 raste dhe janë përkrahur 20 raste, ndërsa gjykata nuk ka pranuar apele.
- Dibra ka 12 apele, është hequr dorë nga apeli ose mospranuar apeli në 4 raste, janë përkrahur 8 apele, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 3 apele.
- Mati ka 9 apele, është hequr dorë ose mospranuar apeli në 2 raste, janë përkrahur 7 apele dhe, gjykata ka pranuar vetëm 3 apele.

Në vijim, vejmë në dukje se nuk janë përkrahur apelet për masa dënimis, ku diferenca ka qenë e vogël dhe për vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore të veprës apo të personit nën hetim. Qëndrim ligjor është mbajtur nga ana jonë për lirimin para kohe me kusht (janë shqyrtuar 9 raste në vitin 2019). Nuk është përkrahur apeli i prokurorit, në rastet kur kemi konstatuar, se gjykatat kanë aplikuar drejt drejt kriteret ligjore për lirimin para kohe me kusht. Gjithsesi, lirimi para kohe me kusht, mbetet problem, pasi deri më sot nuk ka praktikë të konsoliduar dhe asnjë Vendim Unifikues të Gjykatës së Lartë, ku të përcaktohet qartë, se cilat do të konsiderohen arsyet e çështjeve të veçanta për të aplikuar lirimin para kohe me kusht.

Në 786 raste, çështja ka ardhur në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi bazën e ankimit të të pandehurit. **Në 15 raste ose 1.9%**, është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është dërguar çështja për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Të njëjtën linjë ka mbajtur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka prishur dhe kthyer për rigjykim 15 çështje. Theksojmë, se në shumicën e këtyre çështjeve Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën tonë, sepse janë konstatuar shkelje të rënda procedurale në gjykimin në shkallë të parë.

Në 9 raste ose 1.1 %, është kërkuar nga ana jonë pushimi i çështjes përfekt të amnistisë dhe, me të drejtë është pranuar nga gjykata.

Për sa i përket çështjeve të themelit, nga ana e prokurorit është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit me 21 raste ose 2.6% .

Për çështjet e themelit, prokurori ka kërkuar lehtësim pozite në 21 raste dhe pushim çështjeje në 47 raste. Tabela e mëposhtme, ilustron këtë fakt sipas prokurorëve, si vijon:

Nr.	Prokurori	Lehtësuar pozita	Pushuar Çështja
1	Altin Dumani	2	0
2	Dritan Peka	3	2
3	Edi Hyka	3	9
4	Genti Xholi	2	10
5	Nezir Gjoka	3	7
6	Arben Qosja	4	10
7	Fatjona Memçaj	4	9
	Total	21	47

Në 814 raste, nga prokurorët e apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, gjykata ka vodosur lënien në fuqi të vendimit në **616 raste ose 75.6%**, ka lehtësuar pozitën në **21 raste ose 2.5%**, ka pushuar çështjen në **47 raste ose 4,7 %** dhe, ka kthyer për rigjykim **15 raste ose 1,8%**.

Në analizë të treguesve të mësipërm, vërejmë, se janë prishur dhe kthyer për rigjykim 15 çështje, ku të gjitha janë raste të gjykimit në mungesë dhe, nisur nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i cili kërkon që në këto raste, bazuar në kriterin për një proces të rregullt ligjor, konstatohen shkelje procedurale përsa i përket njoftimit të të pandehurve dhe përfaqësimit të tyre në gjykim. Mendoj se edhe këtu ka nevojë që ky lloj gjykimi të rregullohet me ndyshime në K.Pr.Penale.

Është lehtësuar pozita e të pandehurit në 21 raste dhe, kjo ka të bëjë kryesisht, me veprat penale të “drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, me ulje të vogla të masave të dënimit ose aplikimit brenda kritereve ligjore të neneve 53 dhe 59, të Kodit Penal, si dhe vepra penale me autorë të mitur ose me rrezikshmëri të ulët. Në shumicën e rasteve, kur është dhënë pafajësi ose janë pushuar akuzat, nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Po kështu, kemi kërkuar përsëritjen e shqyrimit gjyqësor në disa çështje, mbështetur edhe në ndryshimet e miratuara në Kodin e Procedurës Penale, por në masën më të madhe, nuk është pranuar. Kjo është një nga çështjet, e cila mbetet një ndër priorititetet kryesore në marrëdhënet me gjykatën, pasi do t'a bënte gjykimin në apel të plotë e objektiv, si dhe do të ndikonte në uljen e numrit të çështjeve që prishen dhe kthehen nga Gjykata e Apelit për rigjykim.

Për sa i përket shpërndarjes së çështjeve sipas veprave penale, ato paraqiten si më poshtë vijon:

- Neni 137 i K.Penal, janë gjykuar 55 çështje, me 58 të pandehur
- Neni 248 i K.Penal, janë gjykuar 14 çështje, me 26 të pandehur
- Neni 190 i K.Penal, janë gjykuar 10 çështje, me 33 të pandehur

- Neni 134 i K.Penal, janë gjykuar 65 çështje, me 85 të pandehur
- Neni 259 i K.Penal, janë gjykuar 3 çështje, me 5 të pandehur
- Neni 278/2 i K.Penal, janë gjykuar 34 çështje, me 40 të pandehur
- Neni 279 i K.Penal, janë gjykuar 9 çështje, me 10 të pandehur
- Neni 283 i K.Penal, janë gjykuar 86 çështje, me 112 të pandehur
- Neni 284 i K.Penal, janë gjykuar 9 çështje, me 10 të pandehur
- Neni 290 i K.Penal, janë gjykuar 42 çështje, me 43 të pandehur
- Neni 291 i K.Penal, janë gjykuar 65 çështje, me 65 të pandehur
- Neni 186 i K.Penal, janë gjykuar 16 çështje, me 23 të pandehur
- Neni 189 i K.Penal, janë gjykuar 6 çështje, me 6 të pandehur
- Neni 143 i K.Penal, janë gjykuar 55 çështje, me 58 të pandehur
- Neni 139 i K.Penal, janë gjykuar 14 çështje, me 20 të pandehur
- Neni 236 i K.Penal, janë gjykuar 12 çështje, me 19 të pandehur
- Neni 135 i K.Penal, janë gjykuar 7 çështje, me 8 të pandehur
- Neni 130 i K.Penal, janë gjykuar 120 çështje, me 125 të pandehur

Konstatojmë me keqardhje, rritje të numrit të çështjeve të gjykuara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Po kështu, veprat penale të vjedhjes dhe krimet në fushën e narkotikëve, mbeten ndër vite me tregues të lartë, sikundër vërehet gjithashtu, një rritje e numrit të veprave penale të armëmbajtjes pa leje, çka bën, që goditjen ndaj këtij fenomeni, t'a realizojmë nëpërmjet aplikimit të ashpërsimit të dënimit të kësaj vepre, në përshtatje me ndyshimet e fundit ligjore në Kodin Penal.

Nisur nga numri i çështjeve, në tërësi, Tirana zë numrin më të madh të çështjeve të gjykuara, **852 çështje ose 78.3%**, më pas vjen Kurbini me **68 çështje ose 6.2%** të çështjeve, Kruja me **68 çështje ose 6.2%**, Dibra me **62 çështje ose 5.7%** dhe, Mati me **39 çështje ose 3.6%**. Më poshtë, paraqesim në mënyrë të përbledhur ngarkesën e punës për secilin prokuror, si vijon:

Për çështje themeli

Nr.	Prokurori	Çështje	Apеле	Apel të pand	Pr.Apeli	H.Dorë	Pr.Apeli Gjykata	Rekurse
1	Dritan Peka	72	28	44	10	18	1	-
2	Edmond Hyka	197	53	144	28	25	1	11
3	Nezir Gjoka	200	60	140	37	23	5	16
4	Genti Xholi	181	51	130	33	18	6	5
5	Fatjona Memçaj	208	52	156	35	17	5	10
6	Altin Dumani	32	14	18	9	5	1	10
7	Arben Qosja	199	45	154	26	19	6	29
	Total	1089	303	786	178	125	25	81

Lidhur me masat e sigurimit, kanë ardhur mbi apelin e prokurorit 145 raste ose 14,5 % të rasteve. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë dhee mospranuar apeli i prokurorit në 36 raste ose 24.8 % .

Kryesisht, nuk kemi përkrahur apelin e prokurorit për “Arrest në burg”, pasi i kemi konsideruar vendimet e gjykatave të shkallëve të para të drejta. Këto masa (234, 237 të K.Pr.Penale), janë aplikuar për të mitur, nxënës apo studentë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, si dhe për vepra penale, të cilat janë inicuar me ankimin e të dëmtuarve.

Për sa i përket pranimit të apeleve për masat e sigurimit për vitin 2019, Gjykata e Apelit, nga 109 apele të përkrahur nga prokurori, ka përkrahur 20 apele ose rerth 18.3% të apeleve.

Ndërsa, për masa sigurimi, apelet sipas rrretheve janë:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka 116 apele, është hequr dorë nga apeli në 33 raste, janë përkrahur 83 raste dhe gjykata ka pranuar 16 raste ose 20 %.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka 3 apele, është hequr dorë nga apeli në 0 raste, janë përkraur 3 apele, gjykata ka pranuar 1 apel ose 33.3 %.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka 5 apele, është hequr dorë në 1 rast, janë përkrahur 4 apele, Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 1 apel ose 25.%.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka 15 apele, janë përkrahur 14 apele, është hequr dorë në 1 rast, gjykata ka pranuar 3 apele ose 21.5 %.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, ka 6 apele, janë përkrahur 5 apele, është hequr dorë në 1 rast, gjykata nuk ka pranuar 1 apel.

Përsa i përket masave të sigurimit Tirana ka 816 çështje ose 81.9% të çështjeve, Dibra 35 çështje ose 3,5%, Kurbini 47 çështje ose 4.8%, Kruja 79 çështje ose 7.9%, dhe Mati me 19 çështje ose 1.9%.

Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë në 109 raste. Nga këto, *çështje themeli* 81 dhe *masa sigurimi* 28. Nga ky tregues, del qartë, se kemi rekursuar një numër të madh çështjesh, për mendimin tonë brenda kritereve ligjore. Megjithëse, nuk kemi të dhëna të plota për mënyrën e përfundimit, mbetet domosdoshmëri zgjerimi i objektit të rekursit në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet ndyshimit të K.Pr.Penale.

Për sa i përket masave të sigurimit, nga ana e prokurorëve është kërkuar miratimi i vendimit në 670 raste, nga ana e gjykatës është miratuar vendimi në 575 raste ose rrerh 85,9 % dhe është ndryshuar vendimi në 88 raste ose 13.1%. Në 7 raste është vendosur shfuqizimi i vendimit ose 1% .

Në 326 raste ose 32,7%, nga ana e prokurorëve është kërkuar ndryshimi i masës së sigurimit, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata në përputhje edhe me Kodin e Procedurës Penale, por ka raste, që gjykata nuk merr në konsideratë kërkesën e prokurorit, për caktimin e një mase sigurimi më të butë.

Në Gjykatën e Apelit, gjatë vitit të kaluar, janë gjykuar 225 çështje me objekt shuarje mase sigurimi, ku në 213 raste, nga prokurori është kërkuar shuarja e masës së sigurimit dhe, po kështu, ka vendosur edhe gjykata. Në 12 raste për shuarje mase sigurimi, është kërkuar rrëzimi i kërkesës, për faktin se i pandehuri nuk e kishte vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata dhe, në 1 (një) rast është vendosur pushimi i gjykimit. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe gjykata.

Shkaqet, për të cilat prokurorët kanë kërkuar ndyshimin e masës së sigurimit në një mase sigurimi më të butë, kanë konsistuar në:

- kanë ndyshuar kushtet, rrethanat dhe kriteret ligjore të vendosjes së tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë, me kohën kur kjo masë është gjykuar në Gjykatën e Apelit;
- faktit i është dhënë një kualifikim ligjor për një vepër penale më të lehtë se ajo që është arrestuar në fillim;
- është ndyshuar masa e sigurimit, nga arrest në burg në masa sigurimi më të lehta për të miturit që akuzohen për vepra penale të lehta (vjedhje në sasira tepër të vogla, përdorimi dhe mbatja në sasira të vogla të lëndëve narkotike të tipit cannabis sativa,etj.), të cilat për nga sasia e vogël dhe rrethanat e çështjeve konkrete, krijohej bindja se këto çështje shkonin drejt pushimit të çështjes;
- kanë ndryshuar kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, në kuptim të nenit 260, të K.Pr.Penale.

Nga ana e prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Tiranë, është përballuar një volum i madh pune në studimin, përgatitjen e materialeve dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq për

masa sigurimi. Siç u përmend edhe më lart, prokurorët në Prokurorinë e Apelit Tiranë kanë përfaqësuar në gjykatë, në 996 çështje për masa sigurimi personal e konkretisht:

Për masa sigurimi

Nr	Prokurori	Shuarje mase	masa	Total masa	Apèle prok	Pr.Apel	H.Dore	Pranuar Gjykata	Nd. Masa	Rekurse
1	D.Peka	5	155	160	40	27	13	2	5	2
2	A.Dumani	16	25	41	4	4	-	3	1	-
3	A.Qosja	33	98	131	17	15	2	2	2	7
4	E.Hyka	48	166	214	37	27	10	5	6	6
5	F.Memçaj	13	72	85	6	5	1	2	4	3
7	G.Xholi	88	164	252	30	24	6	4	2	2
8	N.Gjoka	22	91	113	11	7	4	2	1	8
	Total	225	771	996	145	109	36	20	21	28

Shpërndarja e çështjeve penale, sipas veprave penale për masa sigurimi është si me poshtë:

Vepra penale e vjedhjes sipas nenit 134 të KP, me 53 çështje, me 64 të pandehur, neni 291 i KP, me 35 çështje, me 35 të pandehur, neni 278 i KP, me 22 çështje, me 24 të pandehur, neni 283 i KP, me 62 çështje, me 73 të pandehur, neni 248 i KP, me 10 çështje, me 16 të pandehur, neni 139 i KP, me 6 çështje, me 10 të pandehur, neni 290 i KP, me 30

çështje, me 32 të pandehur, neni 236 i KP, me 18 çështje, me 18 të pandehur, neni 143 i KP, me 35 çështje, me 36 të pandehur, neni 130 i KP, me 85 çështje, me 87 të pandehur.

Po kështu, në vitin 2019 janë ekzekutuar 502 urdhëra ekzekutimi. Në zbatimin e urdhërave të ekzekutimit, është mbajtur parasysh ekzekutimi i tyre në kohë sa më të shpejtë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për ekzekutimet e vendimeve penale dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2019, janë përgatitur dhe arshivuar të gjitha minidosjet e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, në të cilën arshivohen akte të tilla si: konkluzione të prokurorit të shkallës së parë, vendimi i gjykatës shkallës së parë, ankimet e prokurorit ose të të pandehurit, konkluzionet e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, aktet e administruara në rastet kur ka patur çelje të shqyrtimit gjyqësor dhe administrim të provave, si dhe rekurset e ushtruara .

Për rezultatet e arritura deri më tash, për vitin 2019, tregues domethënës është edhe bashkëpunimi konstruktiv me drejtuesit dhe prokurorët e prokurorive të shkallëve të para, që mbulon Prokuroria e Apelit.

Vlen të theksojmë gjithashtu, se rezultatet e punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë, gjatë vitit 2019, janë edhe si rrjedhojë e rritjes së bashkpunimit ligjor të vendosur me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me administraten e kësaj gjykate. Po kështu, edhe lidhur me krijimin e kushteve të punës së prokurorëve në mjediset e gjykatës, këto kushte janë përmirësuar. Tashmë, seancat gjyqësore zhvillohen me rregjistrim audio, dosjet vijnë nga gjykata në kohën e duhur për t'u studiuar nga ana prokurorëve, zhvillimi i gjykimit bëhet brenda etikës së seancës gjyqësore, si dhe vërehet rritja e transparencës së gjykimeve, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të gjykatës të listave me të dhënrat e seancave gjyqësore dhe vendimet.

5. Informacion për zbatimin e ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

Shqipëria renditej ndër vendet me përqindjen më të lartë të dhënies së masës së dënimit me burg për fëmijët, si masë dënimisë. Këto të dhëna shqetësuese, për një çështje shumë të ndjeshme për shoqërinë, e bënin të domosdoshme ndërhyrjen e menjëherëshme dhe energjike, për ndryshimin e kësaj praktike të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Drejtësia për të miturit u bë pjesë integrale dhe një komponent mjaft i rëndësishëm i reformës në sistemin e integruar të mbrojtjes për fëmijë, i cili është miratuar në vitin 2018 dhe është në fazën e zbatimit në praktikë. Hartimi i legjislacionit të drejtësisë penale për të mitur, është përqendruar te konceptimi i normave të reja dhe ideimi i mekanizmave të rinj institucionalë, për trajtimin e të drejtave të fëmijëve, sidomos atyre në konflikt me ligjin, viktimate dhe/apo dëshmitarë të veprave penale, në përputhje me standarde tundjezuese dhe rregullat e gjithëpranuara ndërkombëtare të kësaj fushe.

Pikërisht, miratimi i ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, prezanton një qasje të re, rehabilituese dhe riintegruese, pavarësisht rolit që ka i mituri në procesin penal, qoftë në konflikt me ligjin, viktimë dhe /apo dëshmitar dhe, mbrojtja që i ofrohet në këtë rast nga organet kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, duhet të jetë në përputhje me parimin e interesit më të lartë tij.

Konkretisht, institucioni ynë, në rastet e trajtimit të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitar, është përpjekur të garantojë një proces ligjor të dedikuar, për t'i ofruar mbrojtje efektive, si dhe në të njëjtën kohë për të zbatuar korrekt ligjin nr.37/2017.

6. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit duhet vlerësuar si një institucion, i cili veprimtarinë e tij nuk e mbështet tek sanksionet, por te misioni i tij universal e human, që përçon respektin e shtetit ndaj individit dhe vlerave njerëzore. Mjeti ligjor, që Avokati i Popullit zotëron është rekomandimi, gjë e cila e identifikon atë si një organ me një qasje jo ndëshkuese e penalizuese. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga të gjithë mekanizmat shtetërorë përgjegjës, të cilëve u janë adresuar, është detyrim kushtetues.

Në vijim, në mënyrë të posaçme, institucioni i Prokurorisë së Apelit Tiranë, nuk ka patur të adresuar asnjë rekomandim të AP. Sikundër, nëse në të ardhmen do t'i adresohen të tilla, padyshim që përgjegjësia dhe përgjegjshmëria, për zbatimin e këtyre rekomandimeve në praktikë, do të jetë njëherazi edhe përbushje e detyrimit kushtetues nga ana jonë.

Përfundime

Pavarësisht rezultateve dhe treguesve pozitivë, ku vlen të theksohet përkushtimi dhe profesionalizmi i prokurorëve, në drejtë të rritjes cilësore të punës, mbetet ende për t' u bërë. Nisur nga problematikat e hasura në praktikë, **sugjeroj:**

- të punohet më shumë për të përgatitur konkluzione të plota, të argumentuara ligjërisht, në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural, duke dalë kur janë rastet, edhe përtej shkaqeve ligjore, që ngrenë prokurorët e shkallës së parë në apelet e tyre;
- kur hetimi i kryer në shkallë të parë nuk është i plotë dhe, për pasojë nuk krijohet bindje e plotë për kualifikimet ligjore apo plotësim të provave të çështjeve që gjykohen në apel, të kërkohet përsëritje e shqyrtimit gjyqësor dhe plotësimi i hetimit gjyqësor, duke kërkuar prova të tjera shtesë gjatë gjykimit në apel;
- të vazhdohet të mbështeten apelet e prokurorëve për deklarimin fajtor të personave që kane kryer vepra penale, si dhe në rëndim të pozitës së të pandehurit, për sa i

përket masave të dënimit, kur diferenca, ndërmjet kërkesës së prokurorit dhe vendimit gjykatës së shkallës së parë është e dukshme dhe, për vepra penale me përhapje të gjërë të tilla, si: veprat penale në fushën e korruptionit të zyrtarëve e nënpunësve të shtetit, armëbajtje pa leje, krimet kundër jetës dhe shëndetit të shtetasve, krimet kundër pronës, mbajtja, përdorimi dhe tregtimi i lëndëve narkotike, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor.

- të punohet për unifikimin e praktikës së prokurorisë, si ne drejtim të zbatimit të ligjit procedural penal, dhe në drejtim te zbatimit të kritereve të ligjit material në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit për çështje analoge.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj, se pavarësisht vështirësive dhe problematikave të hasura, ndryshimeve rrënjosore kushtetuese dhe ligjore në sistemin e drejtësisë, sfidë kryesore për të ardhmen, mbetet mobilizimi dhe përdorimi i të gjitha burimeve njerëzore e materiale, me efektivitet, përgjegjshmëri, transparencë dhe cilësi, përmirësimi i performancës dhe rritja e efikasitetit, duke shtuar numrin e çështjeve të fituara, për të bërë sadopak e kontribuar në kthimin e besimit të publikut në organet e drejtësisë.

Kjo, në drejtim edhe të përbushjes së një prej kritereve të rëndësishme në procesin e integrimit në BE, atë të ndërtimit e konsolidimit të shtetit ligjor dhe të së drejtës.

Ju faleminderit!

Tirane më 28.02.2020.

DREJTUESI I PROKURORISË

Dritan PEKA

